# DËSHMI ARKIVI

**A-442329**

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | Mbi 1 milion leje qëndrimi për shqiptarët në BE në 18 vjet/ Gjermania kalon Greqinë, bëhet destinacioni i dytë për lejet e qëndrimit në 2025 |
| ADRESA | `https://top-channel.tv/2026/09/14/mbi-1-milion-leje-qendrimi-per-shqiptaret-ne-be-ne-18-vjet-gjermania-kalon-greqine-behet-destinacioni-i-dyte-per-lejet-e-qendrimit-ne-2025/` |
| BURIMI | top-channel.tv |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 14 shtator 2026, 08:14:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| LEXUAR NGA FAQJA | 14 shtator 2026, 07:30:00 UTC<br>*Portali nuk e deklaron datën në asnjë formë makinë-lexueshme; kjo është ora e shkruar për njeriun, e lexuar nga faqja me metodën **text_date**. Dritarja: 14 shtator 2026, 07:29:00 UTC → 14 shtator 2026, 07:31:00 UTC. Kalon nga një rregull i yni që mund të gabojë, prandaj shfaqet si e lexuar dhe jo si e deklaruar.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `2192e89995e36b8a9071ce4f7fd78d263b2428175789a216c882b5003c5196ed` |
| TEKSTI | `5cc2482b7d8b22d2c269f8273ea236c80e5f82891d961eff9fb9a829a5808a9f` |
| PAMJA | `4544acab42fb7f7701f7dfebb0eef25421d2aef6a37ab2a11dd2ff434d9c0a68` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `2fba743047de05fd20727767e5989fff7cc25f96af1f506502cb6f5cf6789c83` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `ac1c8d986ca8a5982bff13c00b3f40fb9a36fbd6d516390a812a54ba861f1b0b` |
| ANKORIMI | submitted — dërguar, ende pa bllok<br>*Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.* |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/2fba743047de05fd20727767e5989fff7cc25f96af1f506502cb6f5cf6789c83`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

AKTUALITET KRYESORE TË FUNDIT

# Mbi 1 milion leje qëndrimi për shqiptarët në BE në 18 vjet/ Gjermania kalon Greqinë, bëhet destinacioni i dytë për lejet e qëndrimit në 2025

14/09/2026 09:30

**Emigracioni i shqiptarëve drejt vendeve të Bashkimit Europian vijon me ritme të larta.**

Sipas të dhënave të Eurostat, nga viti 2008 deri në vitin 2025 vendet e BE-së kanë dhënë gjithsej 1,082,224 leje qëndrimi për herë të parë për shtetasit shqiptarë, ose rreth 1.1 milionë.

Në periudhën 2008-2016 u dhanë rreth 509.5 mijë leje. Shifrat më të larta u regjistruan në vitet 2008-2010, kur jepeshin rreth 70-100 mijë leje në vit. Kjo lidhet kryesisht me emigrantët që ishin larguar në vitet e mëparshme dhe që nisën të formalizonin qëndrimin, sidomos në Itali dhe Greqi.

Në këtë periudhë, Italia dhe Greqia dhanë së bashku rreth 90% të lejeve, përkatësisht 53% Italia dhe 37% Greqia.

Pas vitit 2012, numri i lejeve ra ndjeshëm, duke dhënë përshtypjen se emigracioni po ngadalësohej. Por pas vitit 2016, largimet nisën sërish të rriten.

Vetëm në periudhën 2017-2025 u dhanë rreth 573 mijë leje të tjera, më shumë se në nëntë vitet e mëparshme.

Në të njëjtën kohë, harta e emigracionit shqiptar është zgjeruar. Italia dhe Greqia mbeten vendet kryesore pritëse, por pesha e tyre ka rënë. Në vitet 2017-2025, ato dhanë së bashku 62% të lejeve, me Italinë në 41% dhe Greqinë në 21%.

Gjermania është bërë një destinacion gjithnjë e më i rëndësishëm, veçanërisht për punëtorët e kualifikuar. Në periudhën 2017-2025, ajo dha rreth 20% të lejeve.

Në total, që nga viti 2008, Gjermania ka dhënë rreth 124 mijë leje, duke u renditur e treta pas Italisë, me rreth 500 mijë, dhe Greqisë, me rreth 311 mijë.

Franca ka dhënë rreth 28 mijë leje qëndrimi për shqiptarët që nga viti 2008, Belgjika 14.3 mijë dhe Suedia rreth 13 mijë. Vendet e tjera kanë dhënë më pak se 10 mijë leje secili.

Për Mbretërinë e Bashkuar, të dhënat e disponueshme tregojnë rreth 20 mijë leje qëndrimi për periudhën 2008-2018. Pas kësaj periudhe, të dhënat nuk raportohen në të njëjtën mënyrë.

Britania ka qenë ndër destinacionet më të preferuara të shqiptarëve gjatë viteve të fundit. Në vitin 2022, kërkesat për azil nga shqiptarët në Britani kaluan 14 mijë.

Në vitin 2025 u dhanë 68,653 leje qëndrimi për herë të parë për shtetasit shqiptarë, 4% më shumë se një vit më parë. Në vitin 2024, lejet kishin rënë me 14%.

Gjermania u rendit për herë të parë në vendin e dytë, me rreth 17 mijë leje, pas Italisë


## Kryesore



Tension te Zogu i Zi, protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre
09:38

Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave
08:35

Trump paralajmëron fundin e luftës në Iran: Mund të ndodhë rreth zgjedhjeve amerikane
07:48

Java nis me diell! Ja si do të jetë moti këtë të hënë në Shqipëri
07:05

Lufta për Topin e Artë, Lamine Yamal: Unë dhe Mbappe jemi dy më të mirët, por këtë vit mendoj se e meritoj çmimin
07:58

## Më të lexuarat

"Dil jashtë"/ Debati me Ramën gjatë dëgjesës për 'Territorialen' në Berat, Egla Ceno tregon përballjen me kryeministrin: Doja të flisja, ai u çua i irrituar dhe...

Takimi i Ramës në Berat për Territorialen/ Debate në sallë mes kryeministrit, kryebashkiakut të Poliçanit dhe Egla Cenos

E ndoqi në hotel dhe u larguan së bashku nga klubi i natës, 17-vjeçarja gjermane shokon: Më duket se më përdhunoi një burrë 10 vite më i madh

Exclusive/ "Rastësia që më lidhi me Artur Zhejin", rrëfehet për herë të parë bashkëshortja e publicistit: Kam dashur vetëm ta ndjek dhe ta adhuroj

Rama paralajmëron hapjen e 4 universiteteve të reja në vend, kryeministri zbulon qytetet që do të mirëpresin institucionet arsimore

Takimi në Berat për hartën e re territoriale, Rama: Kokëfortësia kolektive e Poliçanit dhe këmbëngulja e disa zonjave të Dimalit i dhanë...

Video/ 27-vjeçarja ndërmerr aktin ekstrem, hidhet nga kati i 15 i pallatit, bie sipër karrocës me fëmijë

"Pengu për dy fëmijët që nuk erdhën kurrë", Soni Malaj rrëqeth me rrëfimin e saj në Grida Duma Podcast

me 31.7 mijë dhe përpara Greqisë me rreth 10 mijë.

Më pas renditen Franca me 2.4 mijë leje dhe Belgjika me 1.3 mijë, ndërsa vendet e tjera dhanë më pak se 1 mijë leje secili.

Sipas Eurostat, në vitin 2025, 46.3% e lejeve u dhanë për arsye familjare, 29.4% për punësim dhe 0.8% për edukim.

Shifrat tregojnë se emigracioni mbetet një nga faktorët kryesorë që po ndikon në popullsinë dhe tregun e punës në Shqipëri.

**Top Channel**

"Nuk po na lejohet të marrim nga qesja jonë"/ Rama i përgjigjet gjyqtarit: E pabesueshme që e shikon kështu buxhetin e shtetit shqiptar

Kishte dalë me leje nga burgu, "tmerri" i policisë greke Alket Rizai hap zjarr në lokal pas sherrit për muzikën, disa të plagosur

## Aktualitet »



Dënohet agjenti imobiliar në Angli, i siguroi shqiptarëve 9 shtëpi për të mbjellë kanabis me vlerë 2 milion stërlina

14/09 09:52



Tension te Zogu i Zi, protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre

14/09 09:38



Alket Rizai shpallet në kërkim në Greqi, duhej të kthehej në burg në orën 8:00 pas incidentit në lokal

14/09 09:31



Gara për Prokuror të Përgjithshëm në ngërç, Arta Marku kërkon largimin e Sokol Stojanit nga procesi

14/09 09:26



Alket Rizai duhej të kthehej sot në burg, si ndodhi sherri në plazhin grek, shqiptari zhduket nga vendngjarja pas të shtënave

14/09 08:35



Kishte dalë me leje nga burgu, "tmerri" i policisë greke Alket Rizai hap zjarr në lokal pas sherrit për muzikën, disa të plagosur

14/09 08:25

## Kryesore »



PDK sfidon në Kushtetuese procesin e konstituimit të Kuvendit, kërkon pezullimin e hapave të mëtejshëm institucionalë

14/09 10:05




Nis viti i ri shkollor, Berisha ngre alarmin për rënien e numrit të nxënësve: Kemi humbur rreth 5900 brenda një viti

14/09 10:02



Dënohet agjenti imobiliar në Angli, i siguroi shqiptarëve 9 shtëpi për të mbjellë kanabis me vlerë 2 milion stërlina

14/09 09:52



Tension te Zogu i Zi, protestuesit zhvillojnë tubim në ditën e parë të shkollës, shoqërohen disa prej tyre

14/09 09:38



Alket Rizai shpallet në kërkim në Greqi, duhej të kthehej në burg në orën 8:00 pas incidentit në lokal

14/09 09:31



Gara për Prokuror të Përgjithshëm në ngërç, Arta Marku kërkon largimin e Sokol Stojanit nga procesi

14/09 09:26

Na ndiqni:

Top Channel | @topchannelalbania | @tchbreakingnews | Top Channel

## Video »



Top Channel/ “Mos i çoni fëmijët në shkollë”, 106 ditë tubim, protestuesit paralajmërojnë bojkot



Top Channel/ Protesta do riorganizim. Thirrjet e qytetarëve në tubimin e 106-të: Të bashkohemi!



Top Channel/ Rusia godet trenin ukrainas afër Polonisë, evakuohet treni ku udhëtonte Boris Johanson



Top News- “Superkompjuteri do të na vrasë brenda 6 muajve”, Ish-punonjësi i OpenAi jep alarmin



Top Channel/ Trump sfidon ekspertët: Alarmet për Inteligjencën Artificiale janë të ekzagjeruara



Top News- Viti i Ri Hebre, kryerabinj Yoel Kaplan: Shqipëria të vazhdojë të jetë mikpritëse



**© Top Channel 2001 - 2026 • Ndalohet riprodhimi i paautorizuar i përmbajtjes së kësaj faqeje.**

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.